



Në mbështetje të nenit 47, paragrafi 1, pika 6 të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18) dhe nenit 23, paragrafi 2 të Ligjit të Veprimtarisë me Valuta ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 34/01, 49/01, 103/01, 51/03, 81/08, 24/11, 135/11, 188/13, 97/15, 153/15 dhe 23/16), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi:

VENDIM

për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për mënyrën dhe kushtet sipas të cilave rezidentët që nuk janë banka të autorizuar, mund të çelin dhe të kenë llogari jashtë vendit

("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 88/21)

1. Në Vendimin për mënyrën dhe kushtet sipas të cilave rezidentët të cilët nuk janë banka të autorizuar, mund të çelin dhe të kenë llogari jashtë vendit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 42/16 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 50/19, 181/19, 167/20 dhe 308/20), në pikën 1, paragrafi 2, nënparagrafi 2, lidhësja "dhe" në fund të nënparagrafit zëvendësohet me pikëpresje.

Nënparagrafi 3 zëvendësohet me nënparagraf të ri, si më poshtë:

"- në institucionet e huaja të pagesave ose institucionet e parave elektronike; dhe"

Pas nënparagrafit 3 shtohet nënparagraf i ri 4, si më poshtë:

"- në pjesëmarrësin e autorizuar të bursës së huaj ose të tregut të organizuar të letrave me vlerë. "

Pas paragrafit 3 shtohen dy paragrafë të rinj 4 dhe 5, si më poshtë:

"Pjesëmarrës i autorizuar i bursës së huaj ose i tregut të organizuar të letrave me vlerë është personi juridik që ka marrë lejen, pëlqimin ose licencën nga organi kompetent jashtë vendit, për të kryer shërbime me letra me vlerë ose është i regjistruar në një regjistër përkatës publik të pjesëmarrësve të autorizuar në tregjet financiare.

Institucioni i huaj i pagesave ose institucioni i parave elektronike është personi juridik që ka marrë lejen, pëlqimin ose licencën nga organi kompetent jashtë vendit, për të kryer shërbime të pagesave ose emetimin e parave elektronike ose është i regjistruar në një regjistër përkatës publik."

2. Në titullin e Kreut II, fjalët: **"SHËRBIME ELEKTRONIKE"** zëvendësohen me fjalët: **"INSTITUCIONE TË PAGESAVE OSE INSTITUCIONE TË PARAVE ELEKTRONIKE"**.

3. Në pikën 2, nënpika 2.12 ndryshohet si më poshtë:

"2.12 Rezidentët që kanë detyrimin për të paguar në bazë të blerjes së letrave me vlerë jashtë vendit dhe rezidentët që kanë letra me vlerë jashtë vendit, për qëllime të shlyerjes së kërkesave në bazë të shitjes së letrave me vlerë jashtë vendit, dividendit, interesave ose normave të tjera të kthimit në bazë të letrave me vlerë.

Detyrimi për të paguar gjatë blerjes së letrave me vlerë dhe të pagesave nga shitja e letrave me vlerë jashtë vendit dëshmohet me një urdhër për kryerjen e transaksionit ose një raport për transaksionin e kryer, ose një kontratë a dokument tjetër që mund të konfirmojë transaksionin, ose një dokument përkatës që mund të konfirmohet vendosja e një marrëdhënie biznesi midis rezidentit dhe pjesëmarrësit të autorizuar të bursës së huaj ose të tregut të organizuar të letrave me vlerë. Kërkesat në bazë të dividendit, interesave ose normave të tjera të kthimit në bazë të letrave me vlerë dëshmohen me një njoftim/dokument për dividend të paguar, interes ose normë tjetër kthimi nga letrat me vlerë, si dhe një ekstrakt nga llogaria për letrat me vlerë të emetuara nga depozituesi i huaj përkatës.

Në urdhrin për hyrjet e ardhura, baza e transaksionit (shitja e letrave me vlerë, kthimi i mjeteve të pashfrytëzuara, pagesa e dividendit, interesit ose normës tjetër të kthimit) duhet të shënohet qartë.

Llogaria në bankën e huaj ose në pjesëmarrësin e autorizuar të bursës së huaj ose të tregut të organizuar të letrave me vlerë e kësaj nënpike mund të shfrytëzohet vetëm për transferimin e mjeteve drejt dhe nga jashtë, që lidhen me transaksionet me letra me vlerë jashtë vendit.

4. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

"Personat juridikë dhe fizikë rezidentë mund të çelin dhe të kenë lirshëm llogari në institucione të pagesave ose institucione të parave elektronike jashtë vendit, vetëm për qëllime komerciale, pra për blerje/shitje të mallrave dhe të shërbimeve në mënyrë elektronike, deri në 2500 euro vlerë për person në bazë mujore.

Nëse institucionet e huaja të pagesave ose institucionet e parave elektronike të paragrafit 1 të kësaj pike janë gjithashtu pjesëmarrës të autorizuar në bursë të huaj ose në treg të organizuar të letrave me vlerë, në kuptimin e nenit 14 të Ligjit të Veprimtarisë me Valuta, rezidentët, personat juridikë dhe personat fizikë, mund lirshëm të çelin dhe të kenë llogari në to, për qëllime të blerjes/shitjes së letrave me vlerë jashtë vendit, në përputhje me dispozitat e pikës 2.12 të këtij vendimi."

5. Ky vendin hyn në fuqi tetë ditë pas botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

O nr. 02-15/V-1/2021
19 prill 2021
Shkup

Guvernatorja
dhe kryesuesja
e Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë së Veriut
Dr. Anita Angellovska-Bezhoska